VENDIM
Nr. 212, datë 28.12.2017

MBI MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE PËR VITIN 2017 DHE ATË DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT TË SHOQËRISË OST SHA

Në mbështetje të neneve 16 dhe 20, germat "a" dhe "e"; nenit 60, pikat 1; 4 dhe 5; të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike"; neneve 6; 7; 8; 10; 11; 12 dhe 13 të rregullores "Për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë 15.9.2009, si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016 të bordit të ERE-s; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2017, mbasi shqyrtoi relacionin mbi miratimin e planit të investimeve për vitin 2017 dhe atë dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a., të përgatitur nga drejtoritë teknike,

konstatoi se:

- ERE, me shkresat nr. 774 prot., datë 3.11.2016 dhe nr. 275 prot., datë 30.3.2017, i ka kërkuar shoqërisë OST sh.a. paraqitjen për miratim të planit të investimeve për vitin 2017.
- OST sh.a., me anë të shkresën nr. 1771/2 prot., datë 29.5.2017, ka paraqitur në ERE planin e investimeve për vitin 2017.
- Në vijim, ERE, me shkresën nr. 584 prot., datë 30.8.2017, i është drejtuar OST sh.a. për paraqitjen për miratim të planit dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.
- OST sh.a., me shkresën nr. 4677/1 prot., datë 6.9.2017, ka dërguar pranë ERE-s për miratim planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.
- Aplikimi plotëson kryesisht kushtet e përcaktuara në rregulloren "Për procedurat e paraqitjes dhe të miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 62, datë 15.9.2009.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë planin e investimeve të OST sh.a. për vitin 2017, në vlerën 2,183,846,979 lekë.
2. Të miratojë planin dhjetëvjeçar, 2015–2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit në vlerën 285,437,528 euro.
3. OST sh.a. duhet të përditësojë çdo vit planin dhjetëvjeçar të zhvillimit të rrjetit, sipas kritereve të përcaktuara në "Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017.
4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë OST sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

INVESTIMET E PARASHIKUARA NGA OST SHA PËR VITIN 2017 (LEKË)		
1	Zgjerimi i nënstacionit Koman me një autotransformator 400/220 kV	480,557,640
2	Rikonstruksioni i linjës Laç 1-Laç 2 dhe impiantit 110 kV të nënstacioneve Laç 2	194,382,185
3	Furnizim, vendosje e një AT 1Z0 MVA 220/110/35 kV në Elbasan 1	193,818,990
4	Blerja dhe instalimi i analizatorëve të vajit dhe përcaktimit të gjendjes së izolacionit për transformatorët 10 sete DGA	193,480,000
5	Rikonstruksioni impiantit 110 kVh e nënstacionit Jaqodine	180,000,000
6	Rikonstruksioni i impiantit 110 kV të nënstacionit Rubik	140,000,000
7	Rritja e kapaciteteve të transmetimit të OPGW STXK	130,000,000
8	Monitorimi i izolatorëve kalimtarë dhe shkarkimeve parciale	85,000,000
9	Transferimi i QME-së, ndërfaqja me platformën e tregut dhe furnizimi dhe vendosja e dy trakteve të matjes, nënstacioni Kurbnesh, Shutri	80,000,000
10	Furnizim, vendosje e dy çelësave 220 kV në Koman	65,000,000
11	Përfundimi i punimeve për vënien në punë të pjesës kabllore të linjës 110 kV, Tirana 2-Selitë	65,000,000
12	Pajisje primare për mirëmbajtjen e nënstacioneve	50,000,000
13	Blerje të pajisjeve sekondare për zyrën e mbrojtjes (Rele)	50,000,000
14	Implementimi i sistemit të analizimit të rrjetit nëpërmjet PMU (*Phasor Measuring Unit*)	40,000,000
15	Blerje *Server-a, Storage*, pajisje *Network* për *backup site* dhe *disaster recovery* dhe migrim i sistemeve ekzistuese në *Disaster Recovery*	40,000,000
16	Licencë të produkteve *Microsoft*	37,377,428
17	Zhvillimi dhe instalimi i një sistemi për klasifikimin, mbrojtjen dhe parandalimin e rrjedhjes së informacionit elektronik të OST sh.a.	23,000,000
18	Aparate testuese për TR rrymë dhe tension	20,000,000
19	Përmirësimi i infrastrukturës së *Data Network*, *Sistem,* akses kontrolli për hyrje-daljet së bashku me një *Software* për përllogaritjen automatike të pagave	15,000,000
20	Zgjerim i sistemit SCADA mbi kontroll-monitorimin, duke ridimensionuar kanalet e komunikimit IEC 60870-5-104	14,662,500
21	Blerje programi kompjuterik për krijimin, mirëmbajtjen, analizën, konvertimin dhe shkëmbimin e modeleve të rrjetave të transmetimit në formatet që përdoren nga PSSE-ja dhe formatin e kërkuar nga ENTSO-E: CIM Profile, CGMES	13,000,000
22	Blerje kompjuter, laptop dhe pajisje printimi multifunksionale	11,868,236
23	Mbikëqyrja e punimeve për objektet e reja	10,000,000
24	Rinovimi i suportit dhe *upgrade*-im i sistemit të monitorimit të shtyllave të transmetimit	10,000,000
25	Blerje e standardeve IEC	7,000,000
26	Implementimi i menaxhimit të dokumentacionit në mënyrë elektronike	6,000,000
27	Blerje ploter + fotokopje + skaner	5,000,000
28	Ndërtimi i një sistemi me bazë të dhënash për menaxhimin e parametrave të sistemit energjetik	5,000,000
29	Menaxhimi i problemeve të sistemeve të operimit nëpërmjet një sistemi *Issue tracer*	5,000,000
30	Ndërtim bazamenti për autotransformatorin 120 MVA në nënstacionin Elbasan 1	5,000,000
31	Rikonstruksioni i godinës së nënstacionit Koplik	3,000,000
32	Blerje pajisjesh specifike për mirëmbajtjen e sistemeve të kontroll-monitorimit	3,000,000
33	*Updrade*-im/Përditësim i sistemit të monitorimit të automjeteve të OST sh.a.	2,700,000
	TOTAL	**2,183,846,979**

PLANI DHJETËVJEÇAR, 2015–2025, I ZHVILLIMIT TË RRJETIT TË TRANSMETIMIT

	Objektet	Tipi i Percjellesit (mm2)	Gjatesia (km)	Fuqia (MVA)	Viti i Komisioni	Vlera(Euro)
1	Linja 110 kV Uznove - Corovode dhe dalja 110 kV Uznove	ACSR 240/40	33	122	2015	3,320,000
2	Linja 110 kV Lapaj - Peshkopi dhe dy dalje 110 kV	ACSR 240/40	32	122	2015	3,500,000
3	Blerja e dy AT 220/110/10 kV Burrel	2x 60 MVA	-	120	2015	1,600,000
4	Blerja e nje AT 220/110/35 kV Elbasan	1x120 MVA	-	120	2015	1,200,000
	Blerja e nje AT 220/110/35 kV Elbasan	1x120 MVA	-	120	2017	1,200,000
5	Linja 110 kV me dy qarqe Burrel- Bulqize dhe dy dalje linje 110 kV	2xACSR 240/40	30	122	2018	4,000,000
6	Linje e re 110 kV, Rrashbull-Golem -Kavaje	2xACSR 240/40	18	-	2016	1,700,000
7	Linja me dy qarqe Ulez- Shkopet - Skuraj;	2xACSR 240/40	10.5		2016	1,800,000
8	Linja me nje qark Skuraj - Lac-1	ACSR 240/40	12.7			
9	Linja me nje qark Skuraj -Lac-2	ACSR 240/40	10.1		2017	1,800,000
10	Linja me dy qarqe Lac2-Lac1	2xACSR 240/40	2.7			
11	Perforcim Linje 110 kV, Lezhe-Laçi2	ACSR 240/40	19.5	-	2023	1,700,000
12	Perforcim Linje 110 kV, Ulez-Kurbnesh	ACSR 240/40	23.0	-	2021	2,000,000
13	Linje e re 110 kV, Lapaj-Lure, 2 Dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	19.0	-	2023	1,600,000
14	Linje e re 110 kV, Sukth-Gj.Lalzit, 2 Dalje linje 110 kV	ACSR 240/40	18.0	-	2022	1,900,000
15	Linje e re 110 kV, Blulqize-Terrnove-Gjorice	ACSR 240/40	20.0		2021	1,900,000
16	220/110 kV Fierze, 1 Dalje Transformatori 220 kV, 1 Dalje Transformatori 110 kV	-	-	2 x 60	2020	2,000,000
17	Linje e re 110 kV, Kukes-Prizren, 1 Dalje linje 110 kV, Nst. Kukes	ACSR 240/40	13.0	-	2018	1,500,000
18	Perforcim Linje 110 kV, Elbasan1-Fiber, Fiber-Librazhd	2 x ACSR 240/40	30.0	-	2018	3,000,000
19	Perforcim Linje 110 kV, Elbasan1-GSA-Cerrik-Kajan	ACSR 240/40	24.0	-	2019	2,040,000
20	Perforcim Linje 110 kV, Kajan-Kucove-Marinez-Fier	ACSR 240/40	59.0	-	2019	5,015,000
21	Linje e re 110 kV, Fier-Lushnje	ACSR 240/40	30.0	-	2022	2,400,000
22	Plotesim I qarkut te dyte te linjes 220 kV Fier-Babice-TEC Vlore	ACSR 490/65	35.0	-	2020	1,000,000
23	Linje e re 110 kV, Ballsh-Memaliaj-Dragot, N/St. Dragot 220/110 kV	ACSR 240/40	48.0	-	2025	7,080,000
24	Plotesimi i qarkut te dyte te linjes 110 kV, Kuçove-Uznove-Çorovode	ACSR 240/40	58.0	-	2023	1,000,000
25	Linje e re 110 kV, Tirana1-Qender(Kablore), 1 Dalje linje 110 kV.	XPLE-AL1000	2.3		2018	1,500,000
26	Linje e re 110 kV, Koplik-Shkodra1	ACSR 240/40	20	-	2025	1,700,000
27	Linje e re 110 kV, Kosmac-Velipoje	ACSR 240/40	28	-	2024	2,380,000
					TOTALI	285,437,528